

## ABSTRAKTI

**Titulli i temës :** “ Fenomenologjia dhe Etiologjia e veprës penale Vjedhja e Pyllit në territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri, gjatë periudhës kohore 2015-2019”.

**Title of the theme :** "Phenomenology and Etiology of criminal work Forest Theft on the territory of the Mitrovica Basic Court – Branch Of The Struga, during the time period 2015-2019".

Vështrimi juridiko-penal i veprës penale të vjedhjes së pyllit, do flasim për kuptimi dhe llojet e veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, historiku i veprave penale kundër mjedisit, në veçanti ndaj vjedhjes së pyllit, elementet e veprës penale vjedhja e pyllit, format e kryerjes, përgjegjësjësia penale dhe elementet e saj.

Fenomenologjia e veprës penale vjedhja e pyllit në territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtrri, gjatë periudhës 2015-2019, përmban kuptimin e fenomenologjisë kriminale, disa veçori themelore fenomenologjike të vjedhjes së pyllit, vëllimi dhe dinamika e veprës penale vjedhja e pyllit territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtrri, veçorit kohore dhe sezonale, regjionale të veprës penale vjedhja e pyllit, mjetet dhe mënyrat e kryerjes së kësaj veprave penale në territorin e Vushtrrisë, pastaj veçorit personale të kryersve të veprës penale të vjedhjes së pyllit, mosha, gjinia, gjendja ekonomike, statusi martesor, koha e kryerjes, gjinia, niveli i arsimit, recidivizmi i kryersve të veprës penale vjedhja e pyllit. Si metoda dhe teknika hulumtuese janë: metoda historike, metoda juridike, metoda komparative, metoda e studimit të rasteve individuale, metoda statistikore, evidencat statistikore etj. Përmes këtyre metodave dhe teknikave hulumtuese shkencore kam arritur që të njoh dhe trajtoj shumë aspekte dhe probleme të kësaj natyre të veprës penale, por të arrij ti kuptoj shkaqet dhe arsytet e rritjes së kësaj veprave penale në vendin tonë, me theks të posaçshëm në territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, për periudhen e hulumtuar të vitit 2015-2019. Po ashtu përmendim edhe faktoret me ndikim në paraqitjen e vjedhjes së pyllit dhe shqiptimi i sanksioneve penale naj kryersve të saj, në territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtrri, gjatë periudhës 2015-2019. Nga studimi rezultojm se gjatë periudhes kohore 2015-2019, në territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, janë dënuar 142 persona për veprën penale vjedhja e pyllit, ndërsa rritja me e lartë e kryersve të kësaj veprave është në vitin 2019, e me çka kuptojm se natyra e kësaj veprave penale është në rritje enorme, andaj si rekomandim me qëllim të parandalimit të kësaj dukrije është përcaktuar: Shqiptimi i dënimit më të lartë efektiv, rritja e numrit të rojtarëve në zona malore, financimi i ndonjë projekti për mbrojtje e mjedisit etj.

**Fjalët kyçe:** Vjedhja e pyllit, kryersit e veprës penale, dashja, Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, Aktgjykime të plotëfuqishme të shpallura 133, të dënuar 142 persona, etj.

**Mentori:** Prof.Dr.Rexhep Gashi

**Kandidati:** Avdi Ademi